



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 0664057089  
E-mail: [rmuca@klsh.org.al](mailto:rmuca@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. Prot. 1431/14

Tiranë, më 30/7/2019

V E N D I M

Nr. 31, Date 30/07/2019

PËR  
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS  
"NDOTJA AKUSTIKE"

Në zbatim të Planit Vjetor Institucional 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas shkresës nr.1431/8 prot, datë 12.03.2019, Program Auditimi, ndërmori auditimin me temë "Ndotja akustike". Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Institutin e Shëndetit Publik dhe Bashkinë Tiranë. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresat me nr. 1431/9, 1431/10, 1431/11 prot datë 27.05.2019 iu përcoll Projekt-Raporti i Auditimit subjekteve nën auditim.

Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar observacionet e dërguara nga Instituti i Shëndetit Publik me shkresë nr. 1/4 prot, datë 17.06.2019, protokolluar në KLSH me nr. 1431/12 prot, datë 19.06.2019.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt-Vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit, të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja "c" të

Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

## KONKLUDOVA

Raporti i auditimit të performancës me temë "Ndotja akustike" krahas evidentimit të kornizës legislative mbi të cilën duhet të përputhet menaxhimi i zhurmave mjedisore ka synuar në vlerësimin e situatës aktuale të zhurmave. Ky auditim është fokusuar në nivelin në të cilin janë arritur objektivat e manaxhimit të zhurmave mjedisore nga institucionet përgjegjëse, si dhe në ndikimet që ato japin në shëndetin e popullatës me qëllim përmirësimin aty ku është e mundur të situatës aktuale në tërësi. Kushtet të cilat janë të nevojshme për të siguruar efektivitetin kanë të bëjnë me nivelin e performancës së subjekteve nën auditim. Në këtë auditim jemi përqëndruar në Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (së bashku me institucionet e tyre në varësi si AKM, ISHMPUT dhe ISHP) dhe Bashkinë Tiranë si institucion përgjegjës për politikat mjedisore në qytetin e Tiranës. Objektivi kryesor i auditimit ka qenë analizimi i institucioneve përgjegjëse të menaxhimit të zhurmave mjedisore nëse ato kanë vepruar me synimin që t'i garantojnë komunitetit mundësinë e jetesës në mjedise ku garantohet cilësia e shëndetit të qytetarëve dhe zbatohen normat e lejuara për zhurmat.

Masat e marra nga MTM dhe MSHMS si dhe Bashkia Tiranë për manaxhimin e zhurmave mjedisore në vendin tonë nuk kanë qenë efektive. Ministria e Turizimit dhe Mjedisit duke mos miratuar një sërë udhëzimesh ka dështuar të plotësojë kuadrin ligjor mbi zhurmat mjedisore me akte nënligjore edhe pse kanë kaluar 12 vite që nga krijimi i Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis. Bashkia Tiranë nuk ka hartuar politika të përshtatshme lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore. Plani Vendor i Veprimtë të zhurmave, hartëzimi i zhurmave, shpallja e zonave të qeta urbane janë disa nga detyrimet ligjore të cilat Bashkia Tiranë nuk ka arritur t'i përmbushë. Nga ana tjetër, monitorimi i zhurmave nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse si pasojë e buxhetit të vogël të alokuar nga MTM, çka evidentohet edhe në mos përmbushjen e objektivave që vetë Ministria e Turizimit dhe Mjedisit vendos. Mosakreditimi i procesit të monitorimit të zhurmave ndikon gjithashtu në besueshmërinë e ulët të të dhënave. Mungesa e aparaturave të matjes së zhurmave në ISHMPUT, sjell vështirësi në inspektim dhe marrjen e masave konkrete kundrejt subjekteve që lëshojnë zhurma sipër normave të lejuara. ISHP nuk ka kryer asnjë studim epidemiologjik që të vlerësojë lidhjen shkak pasojë mbi ndikimin e zhurmave mjedisore në shëndetin e popullatës.

*Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve:*

## V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë **“Ndotja akustike”**, të ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Institutin e Shëndetit Publik dhe Bashkinë Tiranë.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

- I. *Për Pyetjen: **A është i plotësuar kuadri ligjor mbi ndotjen akustike me akte nënligjore dhe a kanë qenë efektive ato?***

### Gjetje

- Në MTM, nuk ka asnjë sektor/drejtori/specialist të profilizuar dhe përgjegjës lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike.
- Këshilli Teknik për Zhurmat nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar asnjëherë.
- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon rregullimin e territorit, nuk kanë miratuar udhëzimin për kërkesat dhe rregullat për reduktimin e zhurmave në mjedis që në procesin e hartimit të planeve të rregullimit të territorit.
- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon punët publike, nuk ka miratuar udhëzimin për rregullat teknike dhe masat e mbrojtjes nga zhurma që në fazën e projektimit dhe gjatë ndërtimit të ndërtesave.
- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon punët publike, nuk ka miratuar udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e verifikimit akustik të ndërtesave, para se ato të vihen në përdorim.
- Ministri nuk ka miratuar formatin e regjistrit të zhurmës, si dokumenti bazë, ku pasqyrohen të dhënat dhe treguesit e saj, që rezultojnë nga monitorimi dhe matjet.
- Urdhëri i Përbashkët i Ministrave të MTM dhe MSHMS me nr. 58, datë 18.12.2017, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis”, nuk ka përmbushur objektivat e përcaktuara.
- Udhëzimi nr. 1 i Ministrisë të MTM datë 07.01.2012 “Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave” nuk është vënë në zbatim.

### **Për sa më sipër rekomandoj**

- MTM si institucion përgjegjës për hartimin e politikave mbi manaxhimin e zhurmave mjedisore, të marrë masat e nevojshme për vendosjen në organigramën përkatëse të paktën një specialist/sektor ku misioni dhe detyrat kryesore të tyre të jenë lidhur me zhurmat mjedisore.

**Janar 2020**

- Ministri i MTM të propozojë në Këshillin e Ministrave ngritjen e Këshillit Teknik për Zhurmat (KTZH), si organizëm ndërinstitucional këshillimor për çështjet e zhurmës.

**Dhjetor 2019**

- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon rregullimin e territorit, të miratojë udhëzimin për kërkesat dhe rregullat për reduktimin e zhurmave në procesin e hartimit të planit të rregullimit të territorit.

**Janar 2020**

- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon punët publike, të miratojë udhëzimin për rregullat teknike dhe masat e mbrojtjes nga zhurma që në fazën e projektimit dhe gjatë ndërtimit të ndërtesave.

**Janar 2020**

- Ministri i MTM, në bashkëpunim me Ministrin që mbulon punët publike, të miratojë udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e verifikimit akustik të ndërtesave, para se ato të vihen në përdorim.

**Janar 2020**

- Ministri i MTM të miratojë formatin e regjistrit të zhurmës, si dokumenti bazë, ku pasqyrohen të dhënat e treguesit e saj, që rezultojnë nga monitorimi dhe matjet.

**Dhjetor 2019**

- MTM dhe MSHMS të marrin masat e nevojshme për vënien në zbatim dhe raportimin periodikisht të Urdhërit të Përbashkët të Ministrave të MTM dhe MSHMS me nr. 58, datë 18.12.2017, "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis".

**Dhjetor 2019**

- MTM të marrë masat për të vënë në zbatim Udhëzimin nr. 1 të Ministrit të MTM datë 07.01.2012 "Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave".

**Qershor 2020**

II. Për pyetjen: **A janë hartuar dhe zbatuar politika të përshtatshme nga Bashkia Tiranë për manaxhimin e zhurmave mjedisore??**

**Gjetje**

- Bashkia Tiranë nuk ka miratuar Planin Vendor të Veprimit për zhurmat.
- Bashkia Tiranë nuk ka realizuar hartëzimin e zhurmave për qytetin e Tiranës.
- Bashkia Tiranë nuk ka shpallur zona të qeta në territorin që ajo administron.
- Bashkia Tiranë nuk ka vendosur në asnjë rast sinjalistikën e nevojshme për kufizimin/ndalimin e përdorimit të borive.
- Orari i punimeve në lejet e ndërtimit që Bashkia e Tiranës miraton, nuk është i përcaktuar.
- Bashkia Tiranë nuk ka vendosur kritere për përdorimin e materialeve të izolimit akustik në lejet e ndërtimit.
- Bashkia Tiranë nuk ka asnjë të dhënë mbi numrin e popullsisë së ekspozuar në territorin e Bashkisë së Tiranës.
- Drejtoria e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile në BT, nuk e ka të përshkruar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Tiranë përgjegjësinë për dhënien e opinionit për subjektet që aplikojnë për leje mjedisi.

**Për sa më sipër rekomandoj**

- Bashkia Tiranë të hartojë dhe të miratojë me Vendim të Këshillit Bashkiak Planin Vendor të Veprimit për zhurmat.

**Qershor 2020**

- Bashkia Tiranë të drejtojë procesin e hartëzimit të zhurmave pas miratimit të Planin Vendor të Veprimit për zhurmat.

**Dhjetor 2020**

- Bashkia Tiranë të shpallë zona të qeta në përputhje me Planin Vendor të Veprimit për zhurmat.

**Dhjetor 2020**

- Bashkia Tiranë të marrë masa për të vendosur sinjalistikën e nevojshme për kufizimin/ndalimin e përdorimit të borive në zona të caktuara të territorit të Bashkisë Tiranë.

**Dhjetor 2019**

- Bashkia Tiranë të marrë masa për të vendosur kufizime lidhur me orarin e ndërtimit në "lejet e ndërtimit" që ajo miraton.

**Dhjetor 2019**

- Bashkia Tiranë të marrë masa për të vendosur kritere rregullatore për përdorimin e materialeve të izolimit akustik në lejet e ndërtimit që ajo miraton.

**Dhjetor 2019**

- Bashkia Tiranë të realizojë raporte duke identifikuar dhe vlerësuar numrin e popullsisë së ekspozuar ndaj zhurmave mjedisore në territorin që ajo administron.

**Qershor 2020**

- Bashkia Tiranë të marrë masat për të ndryshuar Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe të funksionimit të saj duke përkrahur qartësisht në këtë rregullore strukturën përgjegjëse për dhënien e opinionit për subjektet që aplikojnë për leje mjedisi në përputhje me Udhëzimin nr. 5 të Ministrit të MTM, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, pika 3, gërma f.

**Qershor 2020**

### III. Për pyetjen: **A kanë qenë efektive politikat e ndërmarra nga MSHMS për mbrojtjen e shëndetit publik nga zhurmat mjedisore?**

#### **Gjetje**

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në organikën e saj nuk ka asnjë drejtor/sector/specialist përgjegjës për hartimin e politikave në lidhje me zhurmat mjedisore.
- Në “Udhëzuesin për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”, miratuar me urdhër nr. 234 datë 25.05.2015 nga MSHMS, në kapitullin “Metodologjia e matjeve të zhurmave në rrugë” nuk përcaktohet saktë **frekuenca ose kohëzgjatja** në të cilën duhet bërë monitorimi i zhurmave në një pikë monitorimi.

#### **Për sa më sipër rekomandoj**

- MSHMS të krijojë një sektor në organikën e saj ose të ngarkojë me përgjegjësi të paktën një person me formim dhe eksperiencë në fushën e zhurmave dhe efekteve që ato japin në shëndet.

**Dhjetor 2019**

- **Frekuenca ose kohëzgjatja** sa i përket numrit të ditëve që duhet bërë monitorimi i zhurmave në një pikë monitorimi duhet të përcaktohet saktë në “Udhëzuesin për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”, dhe të jetë disa ditë në stinë. MSHMS të marrë masa për ndryshimin e “Udhëzuesit

për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”, (miratuar me urdhër nr.234 datë 25.05.2015) në përputhje me praktikën zvicerane.

**Dhjetor 2020**

**IV. Për pyetjen: A ka evidenca, raporte apo studime nga institucionet përkatëse mbi efektet negative të zhurmave në shëndetin publik?**

**Gjetje**

- ISHP, ka realizuar në vitin 2014 lidhur me zhurmat mjedisore Raportin me temë “Vlerësimi i prevalencës së çrregullimeve të gjumit dhe bezdisjes së popullatës nga zhurmat e trafikut urban, në qytetet kryesore të Shqipërisë”.
- ISHP nuk ka mundur të vlerësojë barrën mjedisore në shëndet si rezultat i zhurmave mjedisore.
- ISHP nuk ka mundur të vlerësojë nëpërmjet studimeve epidemiologjike efektet negative në shëndet të zhurmave mjedisore për sëmundje të caktuara si për shembull sëmundje kardiovaskulare, hipertension, etj.
- ISHP nuk ka asnjë metodologji/manual/udhëzim për të vlerësuar barrën mjedisore të zhurmave duke përllogaritur “YLL” (Vitet e humbura të jetës) dhe “YLD”, (Vitet e jetuara me paaftësi).
- AKM nuk ka të dhëna mbi ekspozimin e popullatës ndaj zhurmave mjedisore.

**Për sa më sipër rekomandoj**

- ISHP të marrë masa për realizimin e studimeve epidemiologjike dhe përllogaritjen e barrës mjedisore nga zhurmat në shëndetin e popullatës të vendit tonë.

**Dhjetor 2020**

- ISHP të marrë masa për të realizuar një manual/metodologji për përllogaritjen dhe vlerësimin e YLL dhe YLD duke u bazuar në studimin e OBSH dhe Komisionit Evropian. (*Burden of disease from environmental noise, WHO & JRC European Commission, 2011*)

**Dhjetor 2020**

- AKM me qëllim zbatimin me përpikmëri të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit të bëjë të mundur vlerësimin e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave mjedisore dhe ta pasqyrojë në Raportet e Gjendjes së Mjedisit (RGJM).

**RGJM i vitit 2020 e në vazhdim**

**V. Për pyetjen: A është i besueshëm dhe efektiv monitorimi i zhurmave nga AKM dhe ISHP?**

## Gjetje

- Procesi i monitorimit dhe matjeve të zhurmave nga AKM dhe ISHP në periudhën 2016-2018, nuk është i akredituar.
- AKM ka kryer monitorimin e zhurmave në kundërshtim me Ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 7 dhe VKM nr. 1189 datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, Aneksi 1, pika 3, gërma “ë”.
- Frekuenca ose numri i monitorimeve të bëra nga AKM në një vit nuk përfaqëson mesataren e nivelit të zhurmave për pikat e monitorimit.
- Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (PKMM) dhe në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (RGJM) për vitet 2016 dhe 2017 nuk është përshkruar metodika e përzgjedhjes së pikave të monitorimit për qytetet përkatëse.
- RGJM për vitin 2016 ka mospërputhje me PKMM për vitin 2016 lidhur me numrin e pikave të monitorimit.
- RGJM për vitin 2017 ka mospërputhje me PKMM për vitin 2017 lidhur me frekuencën e monitorimit.
- Buxheti i alokuar nga MTM nuk ka mundësuar kryerjen e plotë të monitorimit të zhurmave në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2017.
- Të dhënat për zhurmat që rezultojnë nga matjet vjetore nuk ruhen në arkivin e AKM.

## Për sa më sipër rekomandoj

- ISHP të marrë masa për nisjen, ndjekjen dhe përfundimin e procedurës së akreditimit të procesit të monitorimit të zhurmave mjedisore.

**Dhjetor 2019**

- AKM të marrë masa për përfundimin e procedurës së akreditimit të procesit të monitorimit të zhurmave mjedisore.

**Qershor 2020**

- MTM të propozojë në Këshillin e Ministrave ndryshimin e nenit 7 të Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 7 dhe Aneksit 1, pika 3, gërma “ë” të VKM-së nr. 1189 datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, me qëllim që procesi i monitorimit kombëtar të zhurmave nga AKM të jetë i ligjshëm.

**Dhjetor 2019**

- AKM të marrë masat për kryerjen e monitorimit të zhurmave mjedisore disa ditë në stinë.

**2020 e në vazhdimësi**



- AKM të përzgjedhë pikat monitorimit të zhurmave mjedisore në bazë të gjashtë zonave akustike dhe t'i përshkruajë në PKMM dhe në RGJM.

**Për PKMM dhe RGJM të 2020 e në vazhdimësi**

- AKM të kryejë monitorimin sipas pikave dhe frekuencës së monitorimit të zhurmave të përcaktuara në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

**2020 e në vazhdimësi**

- MTM në cilësinë e institucionit përgjegjës të financimit të procesit të monitorimit të mjedisit të alokojë fondet e nevojshme për kryerjen e monitorimit të zhurmave sipas PKMM.

**Dhjetor 2019 dhe në vazhdimësi**

- AKM të ruajë të dhënat e monitorimit në arkivin e këtij institucioni, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis", Neni 26, pika 2.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

- VI. Për pyetjen: **A është efektiv sistemi i inspektimit për subjektet që gjenerojnë zhurmë?**

#### **Gjetje**

- ISHMPUT nuk ka një "data base" mbi numrin e subjekteve që operojnë pa leje mjedisore.
- ISHMPUT nuk disponon aparatura matëse të nivelit të zhurmave.
- ISHMPUT gjatë viteve 2016-2018 dhe në vazhdim nuk ka bërë asnjëherë kërkesë për buxhet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me qëllim pajisjen me aparaturat matëse të nivelit të zhurmave.
- ISHMPUT gjatë inspektimit në terren bazohet vetëm në raportet e vetmonitorimeve të zhurmave të kryera nga vetë subjektet.
- ISHMPUT nuk ka një platformë elektronike (wep page) institucionale.

#### **Për sa më sipër rekomandoj**

- ISHMPUT të bashkëpunojë me Agjencinë e Mbrojtjes së Komsumatorit (Bashkia Tiranë) dhe me Qendrën Kombëtare të Biznesit me qëllim identifikimin e subjekteve që nuk janë pajisur me leje mjedisore për zhurmat.

**Dhjetor 2019 e në vazhdim**

- ISHMPUT të bëjë kërkesë për fonde pranë MTM për pajisjen me logjistikën e duhur për kryerjen e matjeve të zhurmave mjedisore.

**Shtator 2019**

- ISHMPUT gjatë inspektimit në terren të mos bazohet vetëm në raportet vetëmonitorimeve të zhurmave por të kryejë matje në subjekte që supozohen që tejkalojnë vlerat limite të zhurmave.

**Dhjetor 2019 e në vazhdim**

- ISHMPUT të krijojë një platformë elektronike, me qëllim aksesueshmërinë e saj nga publiku dhe nga institucione të ndryshme.

**Menjëherë**

**VII. Për pyetjen: A është efektiv sistemi i vetëmonitorimit të subjekteve private që gjenerojnë zhurma në mjedis?**

**Gjetje**

- Subjektet që zotërojnë leje mjedisore lidhur me zhurmat nuk i dorëzojnë vetëmonitorimet në kohën e duhur.
- Në Shqipëri nuk ka ekspertë të certifikuar për zhurmat.
- Të dhënat e vetëmonitorimeve deklarohen gjithnjë brenda normave kombëtare të lejuara.

**Për sa më sipër rekomandoj**

- ARM-të të bashkëpunojnë me ISHMPUT, me qëllim verifikimin e subjekteve që zotërojnë leje mjedisore dhe që nuk kanë dorëzuar në kohë raportet e vetëmonitorimeve.

**Tetor 2019**

- MTM të marrë masa për certifikimin e ekspertëve për zhurmat dhe të ngrejë regjistrin e ekspertëve të certifikuar të zhurmës në mjedis, të cilat të jenë të hapura për publikun.

**Dhjetor 2019**

- AKM dhe ISHMPUT të evidentojnë dhe verifikojnë rezultatet e vetëmonitorimeve të subjekteve të pajisur me leje mjedisore për zhurmat.

**Nëntor 2019**

**VIII. Për pyetjen: A është trajnuar stafi i institucioneve përgjegjëse lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore?**

**Gjetje**

- Stafi i MTM dhe MSHMS nuk kanë marrë pjesë në trajnime lidhur me zhurmat.
- Specialistët e ISHP nuk kanë marrë pjesë në trajnime apo konferenca ndërkombëtare lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike.

- Inspektorët e ISHMPUT nuk kanë marrë pjesë në trajnime ndërkombëtare me fokus zhurmat mjedisore dhe nuk kanë organizuar trajnime zhvilluese për inspektorët rajonal.

#### **Për sa më sipër rekomandoj**

- MSHMS dhe MTM si dy institucionet lider në hartimin e politikave lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike të marrin masa për të trajnuar personelin e tyre përgjegjës.

**Janar 2020 e në vazhdimësi**

- ISHP të marrë masa për të trajnuar stafin që merret me manaxhimin e zhurmave mjedisore në trajnime dhe konferenca ndërkombëtare.

**Janar 2020 e në vazhdimësi**

- ISHMPUT të marrë masa për të organizuar trajnime me fokus zhurmat mjedisore, stafin përgjegjës në nivel qendror dhe rajonal.

**Janar 2020 e në vazhdimësi**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**

